



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.06.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Prezantimi i paketës së projektligjeve të reformës në drejtësi.
2. Miratimi i kalendarit për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve prioritare.
3. Prezantimi dhe diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja dhe Vexhi Muçmataj.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Fatmir Mediu dhe Spartak Braho

Të ftuar:

Rainer Deville – shef i misionit EURALIUS, ekspert i nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm

Jon Smibert – këshilltar ligjor rezident i OPDAT-it, ambasada e SHBA-së, ekspert i nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm

Aurela Anastasi – eksperte e nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm

Sokol Sadushi - ekspert i nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm

Gent Ibrahimimi - ekspert i nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit të posaçëm parlamentar, e cila ka tri pika në rendin e ditës.

Së pari, është paraqitja e një memoje, ose e një relacioni, e thënë ndryshe, për përmbajtjen e paketës së projektligjeve të reformës në drejtësi.

Së dyti, është kalendari i shqyrtimit dhe votimit të projektligjeve prioritare në komisionin e posaçëm.

Së treti, është një paraqitje në parim, e shkurtuar, e projektligjit “Për ndryshimet në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”.

Në pikën e parë të rendit të ditës është paraqitur një relacion për përmbajtjen tërësore të projekteve, sipas shtatë shtyllave kryesore në funksion të reformës në drejtësi. Është bërë një paraqitje e përgjithshme për të qenë në dispozicion të komisionit, për të krijuar një pamje më të plotë rreth projekteve që do të shqyrtohen. Natyrisht, sot nuk është qëllimi për t'i shqyrtuar ato një për një, është thjesht një paraqitje, një ekspozitë për të krijuar mundësinë dhe konceptin e asaj që është duke u bërë, e cila do të jetë edhe lëndë e parë për diskutimet që do të bëhen në vijim, sipas fazave në komisionin e posaçëm.

Relacioni është i njohur për kolegët, iu është shpërndarë, por gjithsesi, zonja Shtylla, në cilësinë e drejtueses së sekretariatit teknik, besoj se do ta gjejë të arsyeshme të bëjë një koment të shkurtër. Më pas, kush ka pyetje, mund t'ia adresojë.

Zonja Shtylla, urdhëroni!

Albana Shtylla – Faleminderit, zoti kryetar!

Për materialin e parë, pikërisht në memon e përmbledhur për ecurinë e projektligjeve në zbatim të reformës në drejtësi, do të doja të theksoja se në përfundim të dy fazave të para, të analizës së sistemit të drejtësisë, në të cilin u konstatuan problematikat e vetë sistemit, njëkohësisht u dhanë edhe rekomandimet për përmirësimin e tij, mbështetur edhe në strategjinë e riformimit të sistemit të drejtësisë, dokument ky në të cilin janë politikat kryesore, vizioni për riformimin e sistemit, njëkohësisht edhe për ato që mendoheshin se do të ishin zgjidhjet për problematikat dhe gjetjet e parashikuara në analizën e sistemit të drejtësisë, bazuar edhe në planin veprimit, i cili ishte një dokument tjetër që detajoi në mënyrë të hollësishme të gjitha masat ligjore që do të ndërmerreshin për të adresuar problematikat, por njëkohësisht edhe rekomandimet e dy dokumenteve që përmenda pak më parë. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, i mbështetur edhe nga sekretariati teknik, ka punuar

për një periudhë gati 7-8 mujore për draftimin e rreth 40 projektligjeve për zbatimin e reformës në drejtësi.

Do të doja të theksoja se si fillim, ky grup, në muajt tetor-nëntor të vitit 2015, për çdo projektligj hartoi dokumentin e vlerësimit të hartimit të projektligjeve, në të cilin u shkrua se ku do të fokusoheshin projektligjet, pra u bë një *out line* i këtyre projektligjeve duke sugjeruar edhe një përmbajtje të tyre. Bazuar në këto dokumente vlerësimi, të ndërtuara për çdo projektligj brenda shtatë shtyllave përkatëse, të cilat janë të njohura prej jush, grupet e punës kanë draftuar projektligjet duke punuar në mënyrë periodike dhe në një periudhë jashtëzakonisht të ngjeshur pune për çdo projektligj, por njëkohësisht duke u mbështetur edhe në dokumente që janë përgatitur me mbështetjen e misioneve, të cilat po ndihmojnë pikërisht komisionin e posaçëm parlamentar, misionin EURALIUS dhe misionin OPDAT.

Do të doja të theksoja se në materialin që ju kemi paraqitur ka një fokusim, apo një formatim në tre çështje kryesore, pra, siç e thashë pak më parë, gjetjet dhe rekomandimet, të cilat burojnë nga dokumentet tashmë të miratuara nga komisioni i posaçëm parlamentar. Më tej, ka një pjesë të caktuar, që ka të bëjë me procesin dhe me metodologjinë që ka ndjekur çdo grup pune. Pjesa e tretë ka të bëjë me përmbajtjen e përmbledhur, jo të detajuar, të çdo nisme që tashmë është përfunduar për ato që janë përfunduar, apo është draftuar për ato që janë në proces.

Grupet e punës kanë qenë të formatuara në mënyrë të tillë, që kanë pasur ekspertë të nivelit të lartë, vendas dhe ndërkombëtarë, por njëkohësisht edhe mbështetës të sekretariatit teknik. Përveç këtyre grupeve të punës, të cilat janë marrë në mënyrë të përditshme me draftimin, projektligjet janë konsultuar në një grup që ne e quajmë profesionistësh, por edhe të institucioneve të interesuara, *think tank*. Në grupet *think tank* ka pasur përfaqësues të profesionistëve, dhe këtu e kam fjalët për gjyqtarët, prokurorët, avokatët, noterët, sipas fushës së përmbajtjes së projektligjit. Njëkohësisht, në këto grupe *think tank* ka pasur përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Do të doja të përmendja institucionet e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, të institucionit të Presidentit të Republikës, pse jo edhe ekspertë të grupeve parlamentare, dhe këtu e kam fjalën për ekspertët e opozitës pranë komisionit të posaçëm për reformën në drejtësi, njëkohësisht edhe përfaqësues të fushës akademike. Pas konsultimit të grupeve *think tank*, do të doja të theksoja, faktikisht e keni edhe në materialin që ju është shpërndarë, që nga shtatë projektligje prioritare, për gjashtë prej tyre është mbyllur procesi i konsultimit publik dhe tashmë, në dijeninë time, do të vijohet me procesin e konsultimit publik për projektligjin e fundit, që ka të bëjë me rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në përfundim të këtij

procesi konsultimi, grupet e punës përsëri kanë punuar për reflektimin e atyre mendimeve dhe opinionëve të shprehura gjatë procesit të konsultimit publik, kuptohet, për ato që janë gjetur të mbështetura dhe të argumentuara nga grupet e punës, ndërkohë që për argumentet e dhëna, mendimet e tjera, kuptohet, atëherë kur ato nuk janë marrë në konsideratë, janë dhënë përgjigjet dhe reflektimet përkatëse nga ana e grupeve të punës për subjekte, të cilat i kanë paraqitur ato.

Do të doja të theksoja që për një pjesë të nismave, të cilat janë në këtë memo të përmbledhur, a ka pasur kontribut të posaçëm të misionëve, do të doja të theksoja misionin e EURALIUS-it dhe OPDAT-it, kryesisht duke filluar me paketën e pushtetit gjyqësor me paketën e antikorrupsionit. Këtu dua të theksoj projektligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve”, i cili që ka të bëjë me institucionet që do të merren me luftën kundër korrupsionit dhe me krimin e organizuar, me mbështetjen e posaçme të OPDAT-it.

Po kështu, kemi edhe projektligje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me Kodin e Procedurës Penale, me Kodin Penal, si dhe me Kodin e Drejtësisë për të Miturit mbështetur nga UNICEF-i.

Njëkohësisht ka pasur projektligje dhe nisma që janë marrë nga Ministria e Drejtësisë, të cilat i janë përcjellë komisionit të posaçëm parlamentar nëpërmjet Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë grupet e punës i kanë marrë në konsideratë këto nisma dhe i kanë bërë objekt të diskutimit dhe vlerësimit të tyre. Këtu dua të theksoj projektligjin “Për vlerësimin e gjyqtarëve”, i cili është bërë pjesë e projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Po kështu, janë diskutuar dispozitat e ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me projektligjin “Për trajtimin e të ish- të dënuarve”; me projektligjin “Për shërbimin e provës”; me projektligjin “Për Kodin e Procedurës Penale”; me projektligjin “Për Kodin e Procedurës Civile” e të tjerë.

Për sa i përket përmbajtjes, dua të ndalem vetëm në citimin e projektligjeve, sepse edhe koha ndoshta nuk mjafton. Shtylla e parë ka të bëjë me drejtësisë kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese, ku do të gjeni të përmbledhur në memo dy projektligje: projektligji “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe projektligji “Për Presidentin e Republikës”.

Siç e theksova edhe pak më parë, këto dy projektligje janë hartuar duke u mbështetur në gjetjet dhe problematikat e evidentuara në analizën e sistemit të drejtësisë, por, njëkohësisht, edhe në zgjedhjet që janë propozuar për strategjinë e reformimit të sistemit të drejtësisë dhe në paketën e ndryshimeve kushtetuese, e cila tashmë ka kaluar në komisionin e posaçëm parlamentar.

Lidhur me projektligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, në fokus ka qenë qartësimi i kriterëve të emërimit; përmirësimi i roleve dhe funksioneve të Gjykatës Kushtetuese në aspektin procedural të saj; përjasja e dispozitave me atë çfarë parashikon tashmë paketa kushtetuese lidhur me subjektet, të cilat kanë të drejtë t’i drejtohen pikërisht Gjykatës Kushtetuese.

Për sa i përket institucionit të Presidentit të Republikës, në fakt, është një ligj tërësisht i ri, i cili i ka munguar sistemit të së drejtës. Në këtë projektligj grupi i punës është përpjekur të trajtojë pikërisht kompetencat e Presidentit të Republikës, sipas paketës së ndryshimeve kushtetuese, por njëkohësisht për të adresuar ato raporte, të cilat do të jenë të nevojshme për ushtrimin e kompetencave të tij me Kuvendin apo edhe me institucionet e tjera kushtetuese.

Në paketën e gjyqësorit dua të theksoj tri projektligje tepër të rëndësishme: projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit”, që tashmë mund të konsiderohet një kodifikim i të gjitha dispozitave që kanë të bëjnë me këtë pushtet. Në këtë projektligj, në nene të posaçme, janë trajtuar çështje të riorganizimit të gjyqësorit; pjesa e juridiksionit të tyre; shtrirja e tyre kapilare në të gjithë vendin, si dhe elemente të tjera të rëndësishme për organizimin e pushtetit gjyqësor, siç është administrata e gjyqësorit dhe statusi që ajo do të ketë në vijim.

Në projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve”, siç e thashë edhe pak më parë, në fakt, është bërë pjesë edhe nisma “Për vlerësimin e gjyqtarëve”, e depozituar tashmë në Kuvend nga Këshilli i Ministrave. Njëkohësisht, në këtë projektligj trajtohen të gjitha elementet e rëndësishme, që kanë të bëjnë me promovimin, me karrierën, por edhe me atë që konsiderohet si paketa financiare për gjyqtarët dhe prokurorët jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por dhe pas lënies së detyrës së bashku me familjet e tyre.

Një projektligj tërësisht i ri është edhe ai “Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë”. Ky është një projektligj tepër i rëndësishëm, i cili është punuar nga grupi i punës në drejtimin e zotit Ibrahim, por njëkohësisht edhe të ekspertëve të tjerë të EURALIUS-it. Në dispozitat e këtij projektligji trajtohen elemente më të rëndësishme për sa u përket procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së dhe të KLP-së; do të trajtohen dispozita të veçanta për sa u përket procedurave në të cilat do të funksionojnë këto organe; si dhe për sa i përket Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe më tej Këshillit të Emërimeve.

Dua të theksoj se ky projektligj, edhe për shkak të ndryshimeve , të cilat kanë ndodhur së fundi në paketën e ndryshimeve kushtetuese, është duke u përditësuar për pjesën e organeve të sistemit të drejtësisë. Brenda këtij grupi, siç e përmenda pak më parë, është edhe

projektligji “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”. Dua të theksoj se ndryshimet për kodet, të cilat do të paraqiten në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë, janë ndryshime që synojnë të zgjidhin situatën më emergjente për funksionimin e sistemit, përkundjet procedurave të parashikuara edhe për organet e vetë sistemit.

Brenda kapitullit të drejtësisë penale do të veçoja si projektligj më të rëndësishëm projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”. Në këtë projektligj janë trajtuar, në mënyrë të detajuar, roli dhe funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm; mënyra se si do të funksionojë prokuroria, duke respektuar parimet e vendosura tashmë në paketën e ndryshimeve kushtetuese për sa i përket pavarësisë së funksionimit të këtij organi dhe mënyrës se si do të zërthehet në zbatimin në praktikë; si dhe cilat do të jenë kriteret e emërimit të prokurorëve dhe marrëdhëniet që do të kenë me organet e tjera të sistemit.

Brenda kapitullit të drejtësisë penale do të veçoja edhe ligjin “Për oficerët e Policisë Gjyqësore”. Me mbështetjen e misionit të OPDAT-it është hartuar një projektligj, që parashikon, në mënyrë të detajuar, kriteret e emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, varësinë e tyre, ndërveprimin me organet e tjera të sistemit të drejtësisë, në funksion të hetimit dhe të ndjekjes penale.

Në fakt, dua të ndalem tek të gjitha projektligjet, është Kodi i Procedurës Penale, që do ta vlerësoja si një nismë tepër të rëndësishme. Prej gati një viti misioni EURALIUS ka mbështetur pikërisht Ministrinë e Drejtësisë për arritjen e dispozitave për ndryshimet e këtij Kodi. Këto ndryshime tashmë i janë nënshtruar vlerësimit të grupit të drejtësisë penale dhe mendohet se do të përqasin dhe do të adresojnë problematikat më evidente dhe më emergjente për çështjet e drejtësisë penale ndër vite.

Po kështu, kemi edhe projektligjin “Për Kodin Penal” dhe projektligjin “Për Kodin e Drejtësisë për të Mitur”, por nuk po ndalem tek të gjitha.

Në grupin e antikorrupsionit, siç e përmenda edhe pak më parë, dua të theksoj se projektligjet e këtij grupi janë hartuar kryesisht nga misioni EURALIUS dhe OPDAT. Për projektligjin “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” nga grupi i punës së këtij projektligji ka pasur edhe takime të kryera drejtpërdrejtë në Komisionin Europian.

Ndërkohë, për sa i përket projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin”, i njohur si projektligji “Për SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit”, ka trajtuar në mënyrë të detajuar rregullat për organizimin dhe funksionimin e këtij organi, kushtet shtesë që duhet të kenë prokurorët, të cilët do të jenë pjesë e këtij organi, kushtet që duhet të përmbushin gjyqtarët, që do të jenë, le të themi, brenda këtyre institucioneve të funksionimit, për të luftuar korrupsionin dhe krimin e

organizuar, krijimin e një policie të specializuar përgjegjëse për rastet e rënda të korrupsionit, kompetencat që do të ketë ajo dhe strukturat e tjera, marrëdhëniet e prokurorisë së posaçme me institucionet e tjera e çështje të tjera.

Ligji “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” nënkuptohet është një përshkrim i detajuar i asaj çfarë aneksi i paketës së ndryshimeve kushtetuese ka trajtuar. Në këtë ligj përmbahen aktualisht 65 dispozita dhe trajtohen parimet e organizmit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, metodologjia, procedurat dhe standardet e rivlerësimit, roli i institucioneve që do të kryejnë pikërisht në procesin e rivlerësimit dhe këtu e kam fjalën për Komisionin e pavarur të Kualifikimit, kolegjin e posaçëm të kualifikimit, komisionerin publik, si dhe misionin ndërkombëtar i cili do të asistojë pikërisht në kryerjen e këtij procesi vlerësimi.

Brenda paketës së antikorrupsionit janë edhe një sërë ligjesh të tjera, që kanë të bëjnë me deklarin, kontrollin e pasurive dhe detyrimet financiare të funksionarëve publikë dhe nëpunësve publikë, por njëkohësisht e gjithë paketa ka të bëjë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Antimafia” dhe projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për masat kundër financimit të terrorizmit dhe ato të përgjimeve elektronike””.

Në grupin e edukimit juridik janë tri projektligje. Ndër më të rëndësishmit do të veçoja: projektligjin “Për provimin e shtetit” dhe “Për juristët”, që tashmë është i përfunduar. Nga grupi i punës i është nënshtruar edhe procesit të konsultimit publik. Madje, janë reflektuar edhe mendimet të cilat kanë ardhur nga ky proces i konsultimit, i cili thotë se tashmë është gati për të vijuar më tej me procedurat parlamentare për miratimin e tij.

Lidhur me projektligjin “Për edukimin publik” në bazë të diskutimeve që ka pasur grupi i ekspertëve të nivelit të lartë brenda këtij grupi, ka pasur një ndryshim të statusit, nëse do ta quajmë kështu, të aktit të parashikuar për këtë çështje. Pra, është menduar që të kemi një strategji kombëtare për edukimin publik, i cili është duke u punuar nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë dhe kuptohet më tej pastaj do të ndjekë procesin për miratimin e tij.

Së fundi, në këtë grup do të veçoja projektligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”. Është duke u punuar në mënyrë tepër intensive për këto ndryshime. Ashtu siç jam e informuar edhe nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, ka një draft të paraqitur nga ekspertët e EURALIUS-it dhe mbi të po punohet pikërisht nga ekspertët vendas për të përmbyllur edhe përmbajtjen e këtij projektligji, i cili synon kryesisht të rregullojë çështjet, që kanë të bëjnë me organizmin dhe funksionimin e shkollës, si edhe çështjet, që kanë të bëjnë me trajnimin, duke pasur parasysh edhe kategoritë e reja të cilat do të trajnohen pikërisht nga Shkolla e Magjistraturës.

Grupi i shërbimeve ligjore dhe i profesioneve të lira ka një veçori për sa i përket draftimit të projektligjeve në të, duke qenë se trajton problematika të lidhura me profesionet e lira. Në këtë grup ka pasur një diskutim të vazhdueshëm dhe drafim të dispozitave dhe të ligjeve të parashikuara në të, të ndërlidhura edhe me dhomat që veprojnë në profesionet e lira dhe këtu e kam fjalën për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për avokatinë””. Është punuar ngushtësisht me Dhomën e Avokatisë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për noterinë”, është punuar kryesisht me Dhomën e Noterisë dhe për projektligjin “Përmbartimi privat”, pra, për sa u përket dispozitave të ndryshimeve në këtë ligj është punuar me Dhomën e Përmbartuesve.

Në të tria projektligjet ajo çfarë synohet është: e para, elemente që kanë për qëllim të rregullojnë mënyrën e funksionimit të këtyre dhomave.

E dyta, elemente, që kanë të bëjnë me procedurat disiplinore, të cilat ndërmerren pikërisht nga anëtarët e dhomës, në rastet kur konstatohen shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

E treta, elemente që kanë të bëjnë me trajnimin e anëtarëve të dhomave, që do të thotë me rritjen e kapaciteteve të këtyre dhomave.

Brenda këtij grupi projektligjesh janë projektligji “Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe projektligji “Për avokaturën e shtetit”, i cili është një projektligj i përcjellë nga avokatura e shtetit dhe që u është nënshtruar njëkohësisht diskutimeve brenda grupit.

Grupi i fundit është grupi i financimit dhe i infrastrukturës së drejtësisë. Në fakt, paketa si e tërë, si me krijimin e organeve dhe institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, por edhe me mbështetjen që synohet t’u jepet pikërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve, kuptohet që nuk do të kishte kuptim pa një mbështetje financiare dhe një infrastrukturë që t’i përgjigjet eficiencës dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë.

Në këtë kontekst, në grupin e fundit janë hartuar disa projektligje:

I pari është ai që ka të bëjë me ndryshimet në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”. Konkretisht, në këtë projektligj synohet të përcaktohet, ashtu siç e parashikon edhe Kushtetuta, pavarësia financiare e pushtetit gjyqësor.

Në projektligjin “Për sistemin e caktimit të tarifës gjyqësore” kërkohet të vendoset një sistem tarifash që t’u përgjigjet më mirë pagesave të lidhura me shkallët gjyqësore dhe moskrijimin e diferencimeve midis llojeve të mosmarrëveshjeve.

Për sa i përket ndihmës juridike është konsideruar një projektligj që i adreson të dyja çështjet, si shërbimin ligjor, ashtu edhe paketën e financimit. Kemi një projektligj, i cili

kërkon t'i japë një zgjidhje lidhur me këtë ndihmë jo nëpërmjet një organi administrativ, siç ka vepruar deri tani, pra me një komision të posaçëm pranë Ministrisë së Drejtësisë, por duke ia lënë këtë çështje pikërisht gjyqësorit dhe duke parashikuar në përmbajtjen e tij rregullat specifike për mënyrën se si do të ofrohet kjo ndihmë.

Edhe ky projektligj për ndihmën juridike është hartuar me mbështetjen e misionit EURALIUS dhe është në proces diskutimi nga grupet e punës.

Këto ishin të gjitha, në mënyrë të përmbledhur, lidhur me këtë paketë projektligjesh, pra, rreth 40 projektligje për zbatimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Shtylla!

Ka pyetje? Ndonjë koment shtesë?

Dakord. Kam unë tri pyetje.

E para: Disa projektligje nuk janë paraqitur në memo; kjo është thjesht për ekonomi teksti apo...?

E dyta, me sa kuptoj, jo vetëm nga njohja e procesit, por edhe nga çfarë është parashtruar, 7 ligjet prioritare i kanë kaluar të gjitha fazat e procesit dhe janë thjesht për shqyrtim dhe miratim; pjesa tjetër kur e mbyll të gjithë procesin e konsultimit që të kalojë për shqyrtim në komision, pavarësisht se komisioni deri në mes të muajit korrik do të jetë totalisht i impenjuar me 7 ligjet prioritare.

Pyetja e fundit ka të bëjë me tri ligjet që vijnë nga Ministria e Drejtësisë dhe që janë bërë pjesë e paketës së reformës në drejtësi: a janë të ezauruara dhe a duhen hequr nga kalendari i punimeve të Kuvendit apo duhen përfshirë këtu?

Albana Shtylla – Për pyetjen e parë, e cila ka të bëjë me projektligjet që nuk janë pasqyruar, do të thosha se përveç projektligjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për trajtimin e të dënuarve, si dhe projektligjit “Për Policinë e Burgjeve”, projektligjet e tjera janë të përfshira në memon që është pasqyruar.

Për sa u përket këtyre projektligjeve, në informacionin që kam marrë nga grupet, është punuar në nivel ekspertësh, por nuk kemi ende një version final të tyre për sa i përket vlerësimit. Këtu e kam fjalën edhe për projektligje të depozituara nga Ministria e Drejtësisë, siç është projektligji “Për takimet e të dënuarve”, i cili është një proces vlerësimi brenda grupit të drejtësisë penale.

Për sa i përket projektligjit “Për ndihmën juridike”, unë e kam përfshirë te memoja që ka qarkulluar deri ditën e enjte, ku ka qenë i përfshirë brenda grupit të shërbimeve ligjore

dhe profesioneve të lira, pra do të thotë që është i pasqyruar në brendinë e përmbledhjes së memos.

Për sa i përket pyetjes së dytë, që ka të bëjë me afatet, ne kemi qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me grupet e punës dhe me bashkëdrejtuesit e shtyllave kryesore, për atë çfarë më kanë përcjellë si informacion. Këto projektligje ne i kishim të grupit të dytë, sipas përshkallëzimit të rëndësisë së tyre, që kanë mbyllur konsultimin në *think tank*, çka do të thotë se janë të gatshme për t'u shfaqur në një konsultim publik, ashtu siç u ndoq si procedurë edhe për 7 projektligjet prioritare. Ndërkohë që për projektligje, të cilat janë në nivelin e tretë të rëndësisë apo të prioritetit, të përcaktuara nga komisioni i posaçëm, nuk është mbyllur ende procesi i konsultimit në grupe *think tank*, çka do të thotë se jemi ende në procesin e diskutimit me grupet e profesionistëve, me përfaqësuesit e institucioneve, që kanë çështje të lidhura me përmbajtjen e këtyre projektligjeve.

Për projektligjet e Ministrisë së Drejtësisë, unë e thashë pak më parë, ato u janë shpërndarë grupeve të punës. Ajo çka është orientuar në vazhdimësi, është se këto projektligje duhet t'i nënshtrohen vlerësimit brenda grupeve përkatëse, por njëkohësisht, ashtu siç jam informuar përsëri nga grupet e punës, edhe mendimeve të shprehura nga Ministria e Drejtësisë gjatë proceseve të konsultimit publik, këtu e kam fjalën për 7 projektligjet prioritare; janë vlerësuar nga grupet e vogla të punës, për të pasur një reflektim të tyre në përmbajtjen e projektligjit ose në rast se elemente të caktuara të tyre nuk janë konsideruar të argumentuara për mospërfshirje në brendinë e përmbajtjes së projektligjeve, por nga informacioni që kam marrë projektligjet janë bërë pjesë e diskutimeve të grupeve të punës. Në rastet kur ka pasur vlerësim për to, ato janë bërë pjesë përbërëse e projektligjeve, të cilat po hartohen në zbatim të reformës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje? Dakord.

E konsiderojmë të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

Faleminderit, zonja Shtylla!

Faleminderit edhe kolegëve!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, kalendari i shqyrtimit dhe votimit të projektligjeve prioritare në Komisionin e posaçëm të Reformës në Drejtësi.

A ka vërejtje apo sugjerime?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e shohim të nevojshme të kërkojmë pak më shumë kohë për projektligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ky është i kushtëzuar edhe në paketën e ndryshimeve kushtetuese, kështu që të kërkojmë një javë më shumë nga ç’thuhet në draftin aktual të kalendarit.

Fatmir Xhafaj – Dakord, meqenëse është duke u diskutuar edhe formula, pra pjesa që negociohet. Dakord.

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Lidhur me projektligjet që kemi këtu, si do të procedojmë më tej me atë që quhet “mendimi alternativ”? Do të na pasqyrohet edhe qëndrimi që është mbajtur? Sepse ky ka qenë një proces dhe në momente të caktuara të tij ka pasur edhe ekspertë, që kanë qenë të ngarkuar, pastaj, në proces e sipër, ka pasur edhe ekspertë të opozitës dhe të tjerë, të cilët kanë paraqitur mendime. Pra, do ta konsiderojmë këtë si një proces të shteruar apo do të prezantohen edhe mendimet alternative dhe do të merren vendime? Sepse jemi në një rrethanë tipike: edhe duhet të votojmë, edhe kemi çështje të mbetura pezull, të cilat nuk kanë zgjidhje dhe që mund të afektojnë përmbajtjen e tyre në rast të një dakordësie politike. Ne jemi në një proces të caktuar të shqyrtimit, pra të kalojmë një ligj këtu, kurse në ligje të tjera të reflektojmë qëndrimet e tyre. Po filluam t’i reflektojmë ato, do të na thonë: ato që keni kaluar, reflektojini përsëri! Pra, duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë punë, sepse ka një proces intensiv negociatash e ku di unë; do të na ngatërrojë procesi në rrugë e sipër, kështu që duhet të marrim një vendim dhe të themi: sot do të diskutojmë ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”.

Ky ka qenë mendimi i ekspertëve, por ka qenë edhe ky mendim alternativ, të cilin po e diskutojmë qoftë edhe në mungesë, pra do ta refuzojmë, ose nuk do ta marrim në konsideratë, ose do të marrim vetëm një pjesë, por duhet të shprehemi për këtë punë. Sepse nëse ndodh ndonjë kthim i papritur i opozitës dhe do të fillojmë të jemi më gjithëpërfshirës në diskutim, për disa ligje do të dëgjojmë komente të kundërta dhe do t’i reflektojmë, kurse disa të tjera nuk do t’i reflektojmë, kështu që duhet t’i dalim përpara kësaj pune, me qëllim që të mos i bëjmë nga e para, sepse i trembem edhe kësaj gjëje. Pra, duhet pasur parasysh se katër ekspertët që janë këtu, qoftë edhe ekspertët ndërkombëtarë, i takojnë një kuorumi të caktuar ekspertësh, të cilët kanë pasur një qasje të caktuar. Po raporti me qasjen alternative dhe votimi ynë, që do ta votojmë në parim, do të votojmë nen për nen, do të votojmë në tërësi, do të jetë votim shterues? Në qoftë se ne do të kemi ndryshime eventuale në Kushtetutë, të cilës i referohemi, a na vlen votimi? Këto janë disa pyetje të cilat duhet t’i shterojmë përpara se të shkojmë te shqyrtimi, në mënyrë që të ecim përpara dhe jo të kthehemi pas.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Shqetësimi juaj është i ligjshëm, por më duhet të bëj disa sqarime.

E para, opozita duhet të ishte këtu sot, por është në gjykimin e saj. Ka vendosur të bëjë këtë zgjedhje, që në vlerësimin tim, por edhe në vlerësimin tuaj është një zgjedhje e gabuar. Unë kam komunikuar me zëvendëskryetarin, që është edhe drejtuesi i grupit të përfaqësuesve të opozitës në këtë komision, zotin Bylykbashi, i cili ka parashtruar si argument të vetëm faktin se është duke negociuar për të gjetur një zgjidhje vetëm për formulën. Unë i kam thënë se formula nuk efektikon të gjitha ligjet dhe nuk krijon efekte për të gjithë këtë proces.

Së dyti, ka qenë kërkesë e këtij komisioni, ka qenë një vendimmarrje, ka qenë një vullnet i shprehur nga ne, si maxhorancë, por ka qenë edhe një kërkesë e tyre që 7 projektligjet t'i bashkëngjiten projektit kushtetues, edhe për t'i dhënë më shumë besueshmëri dhe garanci asaj çfarë është shkruar në Kushtetutë, por edhe për të garantuar zbatimin e shpejtë të rregullimeve të reja dhe ndryshimeve të rëndësishme që sjell projekti kushtetues, njëkohësisht edhe për të evituar fazën bllokuese ose fazën që krijohet nga vakancat me krijimin e institucioneve të reja, sepse, nëse nuk do të miratojmë njëkohësisht ose afërsisht në të njëjtën kohë këto 7 projektligje, ndryshimet që sjell projekti kushtetues do të krijojnë një vakum, i cili do të kishte pasoja për rregullimin e sistemit. Unë shpresoj që ata të reflektojnë në ditët në vijim, por kryesorja është të ketë dhe një zgjidhje për atë çfarë është duke u debatuar, duke u diskutuar, duke u negociuar, këtë do ta bënte edhe prezente opozitën.

Nga ana tjetër duhet të mbajmë në konsideratë faktin që në të gjithë këtë diskutim në grupet e vogla të punës, në *think tank*, ekspertët e opozitës kanë qenë pjesëmarrës në një masë të konsiderueshme të këtij aktiviteti, që do të thotë se kanë shprehur opinionet dhe vlerësimet e tyre lidhur me përmbajtjen e projektligjit. Me sa jam unë në dijeni, për shkak edhe se kam qenë i detyruar jo vetëm ta administroj dhe ta menaxhoj të gjithë këtë proces, por edhe e kam artikulluar publikisht, në një pjesë të tyre ata kanë dhënë kontribute konkrete, të dobishme, të cilat janë bërë pjesë e këtij diskutimi dhe janë reflektuar në draftet përkatëse.

Natyrisht, asnjë nga grupet politike parlamentare nuk e ka pasur këtë luks që e ka pasur opozita të ketë përfaqësuesit e vet në grupet e punës, në bërthamat e hartimit, por dhe në *think tank*, gjë që ka qenë e nevojshme për mënyrën si është zhvilluar procesi, për faktin që opozita hyri me vonesë në këtë proces, por edhe për t'i dhënë mundësinë e një përfshirjeje më aktive në funksion të nevojës për të pasur një konsensus sa më të gjerë në të gjithë këtë proces.

Në mungesë të tyre nuk është shumë korrekte të vazhdojmë këtë debat, por dua të them se në mënyrën se si është parashikuar kalendari, dhe këtu bie dakord me ju, i është lënë mundësia që të ketë një njohje, një diskutim, pra një paraqitje në parim, pastaj është shqyrtimi nen për nen dhe është lënë kohë në distancë për votimin në tërësi. Kjo është edhe nisma e një praktike të shëndetshme që ne kemi pasur në Komisionin e Ligjeve, në mënyrë që diskutimet të jenë të shumta dhe deputetët të kenë mundësi të shohin si janë reflektuar ato në trupin, në strukturën, në përmbajtjen e projektligjit në versionin final, me qëllim që askush të mos e kontestojë më pas përmbajtjen e këtyre projekteve.

Natyrisht, nuk është e thënë që për të gjitha të ketë dakordësi të plotë, kjo ndodh si për çdo projektligj tjetër, por synimi do të jetë të ketë mundësi që të ketë sa më shumë dakordësi për zgjidhje të caktuara.

Ndërhyrja që bëri zoti Ibrahim shkon në të njëjtën linjë me ndërhyrjen tuaj, sepse zoti Ibrahim kërkoi një zgjatje të afatit për shqyrtimin e projektligjit “Për funksionimin dhe organizimin organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pikërisht për këtë arsye, për të parë mundësinë se cili mund të jetë efekti i ndryshimit të normave kushtetuese dhe si rrjedhojë e dakordësisë së mundshme për formulën e votimit parlamentar, që është në proces negociimi. E shtyrë në kohë, kjo jep mundësi të shihet si do të ecin këto.

Unë shpresoj dhe besoj se do të ketë një zgjidhje, ndoshta brenda kësaj jave, që të mund të reflektojë në ndryshimin e normës kushtetuese. Natyrisht një gjë është e qartë që ka vetëm një ndryshim dhe ky lidhet me formulën dhe e gjithë ajo efektin kryesisht të ky ligj, por, prandaj e shpjegoj edhe një herë, është bërë vendosja në kohë për votimin në tërësi, në mënyrë që të reflektojmë çdo ndryshim të mundshëm. Gjithsesi, nëse do të kërkohet 1 ditë, apo 2 ditë, apo 3 ditë më shumë, ne në dorë e kemi, mund ta zhvendosim për ta pritur para votimit në tërësi, për ta reflektuar në 1 apo 2 nene. Efekti është shumë minimal nëse do të ketë ndryshime në projektin kushtetues.

A ka mendime të tjera?

Petrit Vasili – Kam një arsyetim të fundit për të pasur një marrëveshje fjale. Në të gjithë paketën me 7 ligje, ne ecim me bindjen që për çdo gjë jemi plotësisht dakord. Kërkimi i kohës nga zoti Ibrahim është shumë fiktiv, sepse nuk jemi këtu për të dhënë kohë, sepse kjo është një kohë politike që nuk varet nga koha e komisionit, dhe ne nuk mund ta bëjmë të tillë. Ne kemi vetëm një keqkuptim, jo keqkuptim, por kemi një distancë, ka gjëra për të ndryshuar, rregulluar, apo përmirësuar vetëm të kjo pikë, dhe apriori jemi të bindur që për gjatë gjëra të tjera kemi dakordësi absolute?! Unë nuk jam kaq optimist se i kemi. Ky është proces përmirësimi dhe nuk mund të jenë distanca të largëta, ato janë distanca, të cilat

rregullohen dhe bëhen sugjerime. Ky proces ka ndodhur vazhdimisht. Por të themi që për 6 ligjet jemi dakord dhe kemi mbetur vetëm të 7-ti... Nëse thuhet me përgjegjësi kjo, dakord, por në rast se pasnesër në darkë gjendet një mirëkuptim, rikthehemi, vijmë pas një jave këtu prapë dhe e kalojmë ligjin për Gjykatën Kushtetuese, atëherë themi: po prit, e hamë procesin e mirëkuptimit tani?! Edhe atje kemi disa rezerva, por të kthehemi dhe të votojmë prapë?! Unë personalisht nuk e votoj dy herë një gjë, po jua them. Besoj se të njëjtën sqimë keni nga pikëpamja politike dhe personale edhe ju. Kështu që, në këtë proces, duhet të jemi pak të kujdesshëm kur të flasim. Po ramë dakord, dakord të ecim përpara. Por duhet të kemi një masë profilaktike, se rikthimi pas do të na dëmtonte shumë në pikëpamje të imazhit dhe gjithsecilin do ta fuste në krizë. Dhe në qoftë se në kalendar është parashikuar që pasnesër ne ta mbarojmë këtë ligj, kështu që i bie së bashku me kalendarin me të cilën ju u njohët edhe tani dhe më pas rikthehemi në kuadrin e një mirëkuptimi të madh. Politika çfarë nuk ka bërë në Shqipëri dhe të vijmë e ta kthejmë prapë, kjo sikur nuk shkon. Kjo mund të ndodhë edhe për ligje të tjera si për projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe për të tjera, përjashtuar më duket SPAKU-n, që sikur ka një dakordësi më të madhe.

Prandaj, them se në lidhje me këto punë, disa përgjigje, disa histori po të kemi parasysh hapësirat dhe fleksibilitetin e duhur, sepse po të vihen në këto rrethana për t’i rivotuar, atëherë do të jetë në planin personal të gjithsecilit për ta votuar apo për ta rivotuar. Pra, t’i kthehemi tri herë së njëjtës gjë, se sot ne u morëm vesh, pastaj vijnë ata, pastaj e ndryshojmë prapë dhe në këtë pikëpamje duhet të dimë edhe diçka tjetër: ne si komision u jemi drejtuar përveç *e-mail*-eve edhe me një letër zyrtare. Sot fillojmë diskutimin e projektligjeve, të cilat janë pjesë e paketës, të cilat, gjithashtu, janë dakordësuar kur ju keni qenë pjesë aktive si opozitë dhe për këtë arsye jemi këtu, kemi një kalendar dhe të negociojmë një datë, një ditë më shumë ose më pak, sepse duhet të kryhet patjetër ky lloj detyrimi nga politik jopublik. Pra, duke u rikujtuar se ka pasur dakordësi sikundër e referuat ju me shumë korrektesë për shumicën e gjërave dhe nuk kemi distanca të largëta të paktën për projektligjet, më pas ai është një proces politik, duan apo nuk duan t’i japim dakordësi është puna e tyre, nuk e kemi këtë hall, por të paktën ta azhurnojmë që ky proces të jetë sa më i shëndetshëm dhe i paatakueshëm, këtu e kam fjalën. Që të mos na ndodhë si në rastin kur ne u detyruam ta shqyrtonim të gjithë së bashku me ata, e shqyrtuam nen për nen e të tjera me radhë, duke mos miratuar gjë dhe në fund fare u detyruam të miratojmë një gjë në mënyrë të njëanshme. Pra, hajdeni t’u dalim përpara këtyre gjërave duke bërë të gjitha ato demarshe që duhen, por të paktën për ta shteruar këtë pjesë, sepse na hyn në punë edhe për të ardhmen e punës së komisionit.

Fatmir Xhafaj – Të jem korrekt me atë që thashë dhe me atë që ju pretenduat. Në asnjë rast unë nuk e thashë që ka dakordësi për shtatë ligjet, se në qoftë se do të ishte kjo, atëherë do të ishte një mrekulli, pra nuk ka sesi të jetë kështu dhe nuk ka pse të jetë kështu. Edhe ne vetë këtu mund të kemi pikëpamje të ndryshme për çështje të caktuara, prandaj shqyrtohet në komision projekti që vjen nga grupi i ekspertëve. Një gjë është shumë e sigurt, që këto shtatë projektligje, ashtu sikundër shumë projektligje të tjera që janë pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi, i janë nënshtruar një diskutimi të gjerë me profesionistët e fushës, me përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë, me aktorët kryesorë të sistemit, kanë qenë pjesë e debatit në *think tank*, e debatit në konsultim publik prej gati rreth një viti. Edhe versionet finale të tyre kanë qenë publike dhe janë shqyrtuar, janë bërë pjesë e një konsultimi publik gjatë muajit të kaluar dhe një pjesë edhe gjatë këtij muaji. Natyrisht, askush nuk thotë që opozita është dakord me të gjitha këto gjëra, ashtu sikundër e thashë që mund të ketë edhe pikëpamje të ndryshme edhe brenda nesh që jemi këtu, për çështje të caktuara dhe kjo është fare normale në mënyrën se si funksionojnë komisionet parlamentare.

Ajo që unë thashë, që është vetëm një pikë që e dakordëson, ka të bëjë me faktin që nga projekti kushtetues është bërë publike, është shprehur edhe zyrtarisht në këtë sallë, por jo vetëm këtu, fakti që ka vetëm një pikë në projektin kushtetues që është ende e diskutueshme, e debatueshme dhe në proces negociimi dhe ajo do të reflektohet në këtë projekt. Pra, nëse do të jetë e nevojshme, do të mund të bëhet një reflektim i mëvonshëm, ndërsa pjesa tjetër do t'i nënshtrohet diskutimit normal që ka në komision. Fakti që ekspertët e opozitës në një pjesë të konsiderueshme kanë qenë aktivë apo kanë kontribuar me kontribute konkrete për përmbajtjen e projektligjeve nuk do të do të thotë asgjë në procesin e diskutimit në komision, për shkak se deputetët mund të kenë pikëpyetjet e tyre, mund të kenë komentet dhe vlerësimet përkatëse për çështje të caktuara. Ajo që unë dua të them dhe që tregon seriozitetin jo thjesht dhe vetëm timin si kryetar komisioni, por të të gjithë këtij komisioni është fakti që ne po insistojmë dhe po realizojmë një gjë që e kemi dakordësuar që në fillim dhe ju keni qenë këtu: faktin që kjo paketë projektligjesh do të shkojë së bashku me projektin kushtetues, për ato arsye që unë i përmenda që në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës. Nëse ne do të presim sa të ketë një zgjidhje për ato amendamente kushtetuese, që janë në proces negociimi, atëherë kjo do ta bënte të pamundur faktikisht shqyrtimin e njëkohësishëm në parlament të projektit kushtetues dhe të projektligjeve që do ta dëmtonte procesin. Unë uroj dhe besoj që mos të jetë ky qëllimi i kolegëve të opozitës, mund ta kenë marrë thjesht si një shenjë presioni për të rritur intensitetin e negociatave apo për të gjetur një zgjidhje, por, nëse do të ishte kështu do të ishte e dëmshme, sepse do të dëmtonte vetë procesin, por do të

dëmtonte edhe atë kalendar që ne të gjithë bashkë, që politika e ka pranuar, që duhet të ketë, për të miratuar këto projekte edhe në funksion të proceseve integruese të vendit.

Gjithsesi, edhe unë e kam shqetësimin dhe nuk është se nuk e vlerësoj këtë aspekt në atë çfarë ju parashtruat, që nëse në një moment të dytë do ta shohim mundësinë për t'iu rikthyer këtyre projekteve, prandaj kam lënë një diferencë midis votimit në tërësi apo shqyrtimit nën për nën në mënyrë që t'u japë mundësi gjatë gjithë këtyre ditëve, edhe të diskutoj dhe të ridiskutoj me ta për të parë një mundësi, po marr versionin që ju vetë e thatë. Ne diskutuam me ditë të tëra, me orë të tëra projektin kushtetues dhe në fund fare opozita nuk e votoi, edhe pse tha që ka një çështje të hapur. Mund të ndodhë që ta bëjë përsëri këtë gjë dhe nëse ne rrimë në pozita pritëse, mund ta shkatërrojmë gjithë procesin. Kështu që ne do të ecim me shumë kujdes, njëkohësisht duke diskutuar dhe duke e ofertuar opozitën që të jetë pjesëmarrëse në këtë proces.

Nuk është hera e parë gjatë kësaj legjislature që ne kemi miratuar edhe në Komisionin e Ligjeve projektligje të rëndësishme dhe opozita nuk ka qenë e pranishme apo nuk ka kontribuar në diskutimin dhe përmbajtjen e tyre dhe ashtu siç nuk i ka votuar, i ka votuar më pas në seancë, pavarësisht se nuk ka marrë pjesë fare në diskutime apo nuk ka votuar. Unë e kam shqetësimin dhe nuk e mohoj që do të duhet që për ndonjë rast, siç është ligji që u citua këtu, por edhe për ndonjë gjë tjetër, t'i rikthem në funksion të zgjidhjes së formulës që u la aty. Do të ecim me mundësinë dhe me shpresën se kolegët e opozitës do të jenë të pranishëm në këtë debat.

Po të shihni kalendarin, do të vini re që ai është shumë i ngjeshur. Me këtë kalendar ne arrijmë datën 15 korrik sikur gjërat të ecin normalisht dhe brenda ritmit në këtë komision, por, në qoftë se ne shmangemi nga ky kalendar, mund të shkojë edhe fundi i korrikut, gushtit, dhe më pas, për një pakujdesi ose mungesë organizimi, ne mund të krijojmë pasoja që nuk do të ishin pozitive, në mënyrë të veçantë për proceset e integrimit të vendit.

Mbetem i hapur për ta pasur në vëmendje këtë çështje.

Dakord me kalendarin në tërësi?

Petrit Vasili - Ka një gabim këtu. Pika 7 "Projekti i rivlerësimit të gjyqtarëve" është venë ditën e mërkurë në datën 11. Duhet vënë e hënë në datën 11.

Fatmir Xhafaj – Kanë bërë një propozim për ta kaluar në parim në datën 6.

Dakord, duke kaluar me pjesën në parim për datën 6, duhet vazhduar normalisht me pjesën tjetër.

Aurela Anastasi - Faleminderit! Ky ishte ndryshimi që ne kemi kërkuar.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim. Faleminderit!

Vazhdojmë me projektligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, një prezantim në parim të projektligjit, të cilin kolegët e kanë përpara.

Së pari, kam një pyetje: a i është shpërndarë ky projektligj vet Gjykatës Kushtetuese?

Paraqitjen do të bëjë zoti Sadushi.

Sokol Sadushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë!

Puna për përgatitjen e projektligjit për Gjykatën Kushtetuese ka nisur në muajin dhjetor dhe që në fillim ne kemi ecur mbi logjikën e amendimit të ligjit dhe jo të një ligji të ri, pavarësisht se ndërhyrja në ligj është e ndjeshme si për shkak të ruajtjes së traditës, por edhe për shkak të ruajtjes së elementit bazë të atij ligji, i cili për 16 vjet ka dhënë efektet e tij pozitive, por që natyrisht ka krijuar edhe problematikë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese.

Metodologjia që kemi ndjekur ka qenë detyra që vuri analiza e gjetjeve në drejtësi, orientimi që vuri strategjia duke ndjekur hap pas hapi tre opinionet që solli Komisioni i Venecias në muajt tetor, dhjetor, janar, shkurt dhe mars dhe të gjitha këto ndikuan që grupi i punës të priret ç[r çdo risi që sillnin pikërisht opinionet e Komisionit të Venecias.

Pjesa e *Think Tank-ut* ka qenë shumë e rëndësishme, sepse organizimi i punës në *Think Tank* ka ndihmuar grupin për të pasur një projekt të mirëkuptueshëm dhe sa më konsensual midis kolegëve. Konsultimi publik më pas, është faza përmbyllëse, e cila shoqërohet me përgatitjen e draftit nga ana e grupit të punës.

Çfarë kemi pasur në vëmendje për përgatitjen e këtij projektligji ka qenë analiza e gjetjeve në tërësi dhe strategjia e drejtësisë, pasi ato kanë evidentuar si problematike shndërrimin e Gjykatës Kushtetuese në një mjet efektiv. Kjo është e lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, ka të bëjë me kritere të qarta profesionale, të cilat duhet t’i përmbushin kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ka të bëjë gjithashtu me përmirësimin e ndjeshëm të procedurave të gjykimit kushtetues. Lidhet, gjithashtu në mënyrë të veçantë me një lloj ridimensionimi të subjekteve iniciuese në Gjykatën Kushtetuese, me një saktësim më të mirë të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, pasjen gjithmonë në vëmendje të faktit që jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut të Strasburgut shpeshherë ka ndëshkuar Shqipërinë, dhe për rrjedhojë, në mënyrë indirekte, ka dalë edhe një problematikë që lidhet me mënyrën sesi Gjykata Kushtetuese gjykon çështjet, qoftë për shkak të mënyrës së vendimmarrjes së saj, qoftë edhe për shkak të ligjit të Gjykatës Kushtetuese me dhënien e pozicionit aktiv të individit në raport me këtë

gjykatë si edhe me shkurtimin e disa afateve, që lidhen me mënyrën e gjykimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Ndërhyrja në ligj është e ndjeshme dhe lind pyetja: përse nuk është ligj i ri? Unë e thashë edhe më parë, që kemi ndjekur metodën që të pranojmë sa më shumë të jetë e mundur të ndërhyhet në ligj duke ruajtur strukturën e ligjit ekzistues, i cili ka pasur një lloj efektiviteti gjatë këtyre viteve, por, sidoqoftë, ngelet në vlerësimin tuaj mbajtja e një qëndrimi tjetër. Ne si grup pune kemi menduar dhe jemi të bindur se amendamenti është zgjidhja më e mirë për sa i përket ndërhyrjes në ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Ndërhyrjet janë bërë nga disa krerë të këtij institucioni.

Ajo që është e veçantë dhe që unë do të doja ta theksoja, krahas atyre që përmenda si risi, është fakti që është shtuar një kre i veçantë, që lidhet me procedurën disiplinore të gjyqtarëve kushtetues.

Nuk ka pse të bëhet dallim midis gjyqtarëve të zakonshëm dhe atyre kushtetues, në fakt, dhe ky ka qenë opinionimi i gjithë grupit të punës. Ata janë gjyqtarë dhe duhet të mbajnë të njëjtat përgjegjësi disiplinore, pavarësisht rolit apo pozicionit më të rëndësishëm që luan gjyqtari kushtetues, por që përpara opinionit publik ata janë të gjithë gjyqtarë. Në këtë aspekt ne kemi përfshirë procedurën që ndiqet për shkarkimin e gjyqtarëve të zakonshëm/të magistratëve, dhe për gjyqtarët kushtetues.

Është risi që gjykimi do të zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese nëpërmjet procedurave të veçanta që ajo parashikon. Ligji ka shumë ndryshime në detaje të cilat ne i kemi parashikuar me hollësi në relacion, por që unë në mënyrë më precize u përpoqa të qëndroj në këto drejtime kryesore, të cilat grupi i punës i ka pasur në vëmendje.

Lidhur me shqetësimin që u paraqit nga zoti Vasili, thjesht po jap një koment, i cili lidhet me faktin që, nëse do të ketë ndonjë ndryshim në draftin kushtetues për sa i përket formulës, vetëm një paragraf do të ndryshojë në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese” që ju e keni përpara, pra vetëm një nen dhe në të gjithë pjesën tjetër ligji mbetet në opinionin tim dhe të kolegëve, i paprekur. Mund të jetë i vetmi i ligj që ka pasur një lloj konsensusi nga përfaqësuesit e opozitës në komision, që e kemi filluar nga ekspertët, sepse kemi gjetur një mirëkuptim për mënyrën e hartimit teknik të dispozitave që lidhet dhe me draftin kushtetues për pjesën e Gjykatës Kushtetuese, por lidhet edhe me fillimin e punës të ligjit të Gjykatës Kushtetuese. Kështu që mendojmë se i vetmi nen që mund të mbetet për t’u riparë, nëse mund të rishihet nga ana e deputetëve, duhet të jetë vetëm neni që ka të bëjë me procedurat e emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi.

Në projekt është parashikuar, ashtu siç dhe sugjeron Komisioni i Venecias, një formulë me shumicë të cilësuar për 3 gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që zgjidhen nga Kuvendi. Pjesa tjetër pastaj ngelet e pandryshuar. Në opinionin tonë mendojmë se në aspektin teknik ky projektligj ka gjetur konsensusin më të gjerë të mundshëm dhe për mënyrën se si është zhvilluar debati brenda grupit të punës. Detajet i trajtoi zonja Shtylla për mënyrën se si ka ecur procesi. Në relacion janë të gjitha të detajuara. Në qoftë se ka pyetje të aspektit teknik, unë dhe kolegët jemi të gatshëm për këtë gjë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A ka nga ekspertët ndonjë gjë për të shtuar? Po, zoti Deville.

Rainer Deville – *(flet anglisht)* Një detaj i këtij ligji është që të shikohen edhe elementët e anti-korrupsionit dhe kjo vlen për të gjithë legjislacionin që vjen. Bashkimi Evropian është, sigurisht, mjaft i interesuar që të gjitha masat anti-korrupsion të zbatohen dhe kjo duhet të kalojë deri në detajet e ligjit. Veçanërisht nuk duhet anashkaluar *vetting-u* madje edhe për këshilltarët ligjorë. Kjo mund të përbëjë një shqetësim që vjen madje mund të arrijë deri në nivelin politik, pra është diçka që duhet të shohim. Anti-korrupsioni është një nga gjërat më madhore që do të shohë Bashkimi Evropian.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A ka ndërhyrje të tjera? Dakord.

Relator për këtë projektligj do të jetë zoti Majko, të cilit në seancën e ardhshme do t'i japim mundësi që të paraqesë vlerësimet dhe komentet përkatëse lidhur me përmbajtjen e projektit. Kush ka pyetje rreth projektligjit?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Unë para së gjithash dua të falënderoj ekspertët për prezantimin e nismës, por njëkohësisht edhe të gjithë grupin që ka përgatitur memon për përmbajtjen e paketës së projektligjeve të reformës në drejtësi!

Lidhur me ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ju, zoti Sadushi, thatë se ndryshimet janë të mëdha në numër, por janë edhe esenciale, në mendimin tim. Ligji ka 92 nene dhe mendoj se ka më shumë nene sesa ka vetë ligji ekzistues i Gjykatës Kushtetuese.

Nga ana tjetër e mirëkuptoj idenë se kemi gjykuar që më mirë të mos kemi një ligj të ri, por të kemi një shtesë dhe ndryshim. Cila është pengesa për të përfshirë, për të inkorporuar

të gjitha këto ndryshime dhe për pasuar një variant integral, pra një ligj të ri. Unë jam në favor të një ligji të ri? Këtë pyetje e bëj bazuar në 3 konstatime.

Ju keni rregulluar disa institute shumë të rëndësishme që në ligjin ekzistues nuk janë. Pra, në mënyrë të detajuar procesin disiplinor, keni rregulluar ankimimet, procedurat, seancat, vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, efektet e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare të Gjykata Kushtetuese. Keni shumë nene të shtuara, por keni dhe krerë të shtuar. A mos do të ishte më mirë që të ishte një ligj i ri? Unë mendoj se nuk ka pengesë ose nuk ka vështirësi që të gjitha këto dispozita të përfshihen dhe të shfaqen në një ligj të vetëm. Këtu kam parasysh dhe faktin që Gjykata Kushtetuese shumë herë nëpërmjet kryetarit të saj ka depozituar në tryezat dhe në diskutimet që kemi bërë nevojën e një ligji të ri. Ka pasur një kërkesë për të pasur një ligj të ri.

Lidhur me pjesët e tjera nuk kam komente. Ruaj të drejtën kur të diskutojmë në parim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Sadushi.

Sokol Sadushi - Faleminderit!

Unë e thashë që mund të ishte ndjekur dhe teknika e hartimit të një ligji tërësisht të ri. Ka një arsye të cilën unë nuk e thashë. Ndoshta po marr spunto dhe nga pyetjet që bëtë ju. Ne kemi ndjekur këtë lloj teknike legjislative për një arsye që është ndoshta thelbësore. Ndoshta është i vetmi institucion, i cili, jo për ta vlerësuar më shumë nga të tjerët, është anatemuar më pak nga të tjerët. Në raport me gjykatën, në përgjithësi me gjyqësorin, në raport me prokurorinë, në raport me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në raport me Gjykatën e Lartë, ku ka ndryshime rrënjësore në draftin kushtetues, te Gjykata Kushtetuese i vetmi ndryshim që mund të quhet thelbësor është vetëm formatimi. Natyrisht pjesa e procedurave pastaj është pjesë e ndryshimit, por nuk ka atë ndryshim Gjykata Kushtetuese siç ka në tërësi gjyqësori.

Prandaj lindi nevoja në gjyqësor që të jetë një ligj i ri për organizimin gjyqësor. Prandaj në prokurori lindi nevoja të ketë një ligj të ri për prokurorinë, apo të ketë një ligj të ri për Këshillin e Lartë të Drejtësisë që përfshihet brenda organeve qeverisëse. Kështu që nga kjo pikëpamje ne jemi nisur edhe nga ky aspekt për të dëshmuar që jurisprudenca në Gjykatën Kushtetuese apo veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese ka pasur një vijimësi të qëndrueshme dhe ligji vërtet ka krijuar problematika, por jo problematika të atilla sa të na çonin në një ide për të bërë një ligj tërësisht të ri. Është e vërtetë që ndërhyrja në ligj është e

ndjeshme, por ju e dini tashmë që ka përvoja të ndryshme shekullore nga shumë shtete që, megjithëse ligjet apo kushtetutat preken, ato preken me amendime dhe jo me ligj. Ne këtë vlerësim kemi pasur për sa i përket ligjit të Gjykatës Kushtetuese, për të përdorur termin e amendimit. Sidoqoftë ky ngelet një vlerësim për të cilin natyrisht deputetët do të kenë dhe opinionet e tyre, por në opinionin e grupit tonë është menduar që amendimi ndoshta është zgjidhja më e arsyeshme, duke menduar që nuk kemi një ndryshim rrënjësor të institucionit në raport me institucionet e tjera kushtetuese, të cilat ndryshojnë rrënjësisht me draftin kushtetues.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Kam unë disa pyetje.

E para, po e filloj nga një gjë më e thjeshtë. Kam përshtypjen se afatet procedurale këtu janë shumë të shkurtra, sidomos në rastin e emërimeve, sepse tejkalimi i tyre mund të krijojë probleme në praktikë, por mund të dëmtojë edhe cilësinë e procesit. Duke qenë se ne mund ta bëjmë shumë kohë më parë shpalljen e vakancës, a mund të zgjaten afatet për t'u dhënë mundësi organeve përgjegjëse të kenë të gjithë hapësirën e nevojshme për të vepruar, natyrisht në funksion të cilësisë së procesit?

Së dyti, ju keni praktika të ndryshme për institucione të ndryshme në momentin e emërimit. Për shembull, ju keni zgjedhur që Kuvendi të votojë me 3/5-t (ky është propozim, sepse mund të jetë edhe me 2/3-t dhe kjo është një çështje tjetër që nuk është zgjidhja juaj, por është zgjidhja jonë) dhe i keni lënë vetëm një votim. Nëse nuk realizohet ky kuorum me një votim, ju i referoheni Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kur shkoni te rasti i Gjykatës së Lartë, bëni dy votime dhe aty lini shumicën e thjeshtë të atij që ka marrë më shumë. Pse është kjo diferencë? Pse e ka këtë luks Gjykata e Lartë dhe nuk e ka Kuvendi, ose anasjelltas?

E treta, që lidhet me diferencën ose më saktë me qëndrime të ndryshme për organe të ndryshme, pse për Kuvendin u keni dhënë mundësi grupeve të interesit, grupeve të profesionistëve, të shprehen për kandidatët? Pse nuk keni bërë të njëjtën gjë edhe për kandidaturat që sjell Presidenti, edhe për kandidaturat që sjell Gjykata e Lartë? Ku qëndron diferenca? Nëse keni logjikën që këtu është një trupë politike, edhe Presidenti politik është me kuorumin që ka. Edhe gjykata, në pikëpamje të nevojës që ka për të pasur rendësi, duhet t'i dëgjojë këto opinione, por në pikëpamje të nevojës që ka opinionin publik për të ditur se kush po shkon në Gjykatë Kushtetuese, mendoj se nuk ka arsye pse duhet ta bëjmë këtë përjashtim.

Çështja tjetër lidhet me kriteret. Po e them që në fillim: nëse prisja një gjë më të re, është çështja e përforsimit të kriterëve për ata që shkojnë në Gjykatën Kushtetuese, për në Gjykatën e Lartë etj., pavarësisht se unë nuk jam shumë dakord edhe për kohën, që keni lënë 15 vjet, por ka një sensibilitet të marrë politik këtu në Shqipëri dhe përkohësisht mund të pranohet kjo marrëzi, pra fakti që duhet të kesh 15 vjet përvojë që të shkosh në Gjykatën Kushtetuese. Sipas kësaj logjike, mund të shkosh 40 vjeç në Gjykatën Kushtetuese. Gjithsesi, ky është momenti në të cilin diskutohet. Kriteret këtu janë aq të përgjithshme, sa nuk e bëjnë dallimin nëse është ai njeriu që duhet të shkojë në Gjykatë Kushtetuese apo dikush tjetër që mund të bëjë çdolloj pune tjetër në sistemin e drejtësisë, sepse edhe atje, ku keni kërkuar të ketë meritë apo veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, i keni futur edhe një bisht, “ose në sfera të tjera të së drejtës”. Kjo gjë për mua nuk ka kuptim. Pyetja është: a nuk do të ishte me vend, duke reflektuar edhe në disa praktika jo të shëndetshme të emërimeve të mëparshme në Gjykatën Kushtetuese, t’i përforsojmë kriteret e atyre që kandidojnë në Gjykatën Kushtetuese, sepse ai që shkon në këtë gjykatë, që është gjykata më e lartë e vendit, duhet të ketë kriterë shumë të forta të dijeve, të integritetit dhe të aftësisë së tij profesionale. Ky është një filtër shumë i përgjithshëm. A është e mjaftueshme kjo, apo mendoni duke gjykuar në bazë të precedentëve të mëparshëm?

Po, zoti Sadushi.

Sokol Sadushi – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Po u përgjigjem një pjesë të tyre, ndërkohë që edhe kolegët, për shembull, zoti Rainer, mund të japin opinionet e tyre.

Po e filloj me pyetjen e parë, për afatet e shkurtra për emërimin apo për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Në fakt, në draftin kushtetues është parashikuar që tre muaj përpara përfundimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues fillon e gjithë procedura, që lidhet me transparencën, me bërjen publike, me faktin që pas tre muajve do të ketë një vend bosh etj. Kështu, fakti që fillon tre muaj përpara, është një risi në raport me atë që sot kemi në përzgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Afatet që lidhen me momentin kur ndërhyt Kuvendi, Presidenti dhe Gjykata e Lartë në vlerësimin tonë nuk janë shumë të shkurtra, maksimumi një muaj, duke menduar se periudha tremujore përpara përfundimit të këtij mandati ka shërbyer për një lloj gjykimi publik të kandidatave, si dhe ka shërbyer për të vlerësuar gradualisht se me kë kemi të bëjmë. 30 ditë mendojmë se është një periudhë e arsyeshme për të bërë edhe një lloj presioni në aspektin pozitiv ndaj institucioneve të veprojnë shpejt për zgjedhjen e këtyre kandidatave dhe për të eliminuar përvojën negative që ka pasur Gjykata Kushtetuese, sepse janë detyruar gjyqtarët të qëndrojnë në detyrë tej mandatit të tyre, sepse

nuk vepronin institucionet. Vendosja e afateve të tilla kemi bindjen se do të krijojë një lloj presioni pozitiv ndaj institucioneve. Mendoj se afatet nuk janë të shkurtra, por janë të arsyeshme.

Lidhur me pyetjen e dytë, për sa i përket diferencimit që është bërë për zgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Lartë me dy votime, në raport më atë që bëhet me Kuvendin, në fakt kemi dashur ta diferencojmë institucionin politik nga ai gjyqësor. Kemi menduar se është e nevojshme një votim dy herë në Gjykatën e Lartë. Përse nuk bëhet dy herë edhe në Kuvend?! Për Kuvendin kemi zgjedhur këtë ndoshta edhe për shkak të qasjes që kishte reforma apo i gjithë procesi për një lloj depolitizim të procesit dhe për një lloj ndikimi sa më pozitiv ndaj ligjvënësit për të vepruar qoftë edhe më një votim. Mendojmë se kemi gjetur një zgjidhje të arsyeshme, por nuk e dimë nëse kemi gjetur zgjidhjen më të përkryer. Sidoqoftë, kjo është vlerësuar në këtë mënyrë nga ana e kolegëve.

E njëjta përgjigje është edhe për pyetjen e tretë se pse është bërë një dallim të Kuvendi lidhur me përzgjedhjen e gjyqtarëve që të merret opinioni... Në fakt, ndoshta kjo është një ndërhyrje e drejtë nga ju. Jemi prirur gjithmonë për të bërë një presion më të madh mbi politikën që, sa të jetë e mundur, të ketë në vëmendjen e saj edhe grupet e interesit, pra marrjen e opinioneve nga këto grupe interesi. Nuk mendojmë se është një dispozitë që mund të zërë vend te Gjykata e Lartë apo të Presidenti. Megjithatë, në mënyrën si ju ndërhyni, krijoni konkluzionin që, për sa kohë që Presidenti zgjidhet në mënyrë politike përse të mos ta ketë edhe në procedurën e zgjedhjes së Presidentit. Ne kemi menduar se ndoshta duhet të orientohet më shumë te Kuvendi ky lloj formulimi për sa u përket grupeve të interesit. Sidoqoftë, kësaj gjëje ndoshta kolegët mund të japin ndonjë opinion më të plotë nga kjo që sapo thashë.

Për sa i përket pyetjes që lidhet me kriteret, në fakt, çështja e kriterit apo e vjetërsisë 15 vjet është një çështje shumë e diskutueshme. Fillimisht, kur ne në projektin e parë kushtetues vendosëm kriterin për Gjykatën e Lartë, për shembull, 15 për gjyqtarët e zakonshëm kurse 20 vjet për ata që vijnë nga jogjyqësori, u anatemuam shumë në opinion, sepse dukej sikur kishim përjashtuar nga kjo kategori ata që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Po ashtu pati dhe anatemime që me 20-vjetshin, dashur padashur, dukej sikur donim të sillnim në sistem ata që e kanë përfunduar shkollën në kohën e komunizmit. Nga diskutimet që kemi pasur, edhe në draftin kushtetues, ne kemi reflektuar dhe kjo zgjidhje që kemi dhënë për 15 vjet është rrjedhojë e draftit kushtetues nuk është rrjedhojë e ligjit. Pra, jemi imponuar nga ulja e viteve në draftin kushtetues për sa i përket përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të lartë, që automatikisht e ka sjellë efektin e tij edhe

në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”. Mendojmë se 15 vjet është një afat optimal për të qenë në Gjykatën Kushtetuese, por jo domosdoshmërisht të gjithë gjyqtarët në vitin e 16 të vijnë në Gjykatën Kushtetuese, ky është minimumi për 15 vjet, që do të thotë: të mos përjashtohet mundësia të ketë edhe nga ata që, me të drejtë ngrihet problemi që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe të jenë dhe gjyqtarë kushtetues. Sidoqoftë, unë nuk e lidh me këtë arsye, por kemi menduar që 15 vjet është një afat i arsyeshëm për të qenë në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me pyetjen e fundit, e cila përsëri lidhet me kriteret, në fakt, në ligj kemi synuar të jemi sa më të detajuar, ndryshe nga ligji ekzistues, për sa i përket evidentimit të kriterëve që duhet të plotësojë një kandidat për gjyqtar kushtetues. Në nenin 6, që ndryshon, bëhet fjalë për nenin 7/a, pika 3, janë listuar, në një mënyrë të kënaqshme të gjitha ato kriterë, të cilat në qoftë se do të respektohen, jemi të bindur që prurjet në Gjykatën Kushtetuese do të jenë të mira.

Zoti kryetar, shqetësimi juaj lidhur me fushat e tjera të së drejtës, është për të mospërjashtuar juristë të shquar, që nuk janë të specializuar vetëm në të Drejtën Kushtetuese dhe në të Drejtën e Njeriut, por edhe në fusha të tjera të së drejtës, sepse e dimë që në Gjykatën Kushtetuese ka nevojë edhe për penalistë mjaft të mirë, edhe për civilistë mjaft të mirë, edhe për disiplina të tjera të së drejtës. Kështu që një formulim i tillë nuk përjashton asnjë nga kategoritë e juristëve të shquar që mund të jenë pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, për listimin e të gjitha kriterëve të tjerë, në qoftë se do t’i respektojmë me rigorozitet, jam i bindur që edhe Këshilli i Emërimeve do të bëjë seleksionimin e tij mbi bazën e çdo kriteri prej këtyre që kemi evidentuar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zonja Anastasi!

Aurela Anastasi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam dy ndërhyrje të vogla, në plotësim të fjalës së kolegut. Meqenëse ju shtruat si çështje të përgjithshme çështjen e afateve, dua të shtoj se afatet për individët për afatet e gjykimit janë përcaktuar këtu, duke mbajtur parasysh standardet më të mira, sidomos në lidhje me afatet e gjykatave ndërkombëtare, veçanërisht të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Fakti që janë zvogëluar këto afate, sepse do ta vini re se janë ngushtuar këto afate në mënyrë të ndjeshme, ka të bëjë me nevojën që ka shtruar praktika vazhdimisht, por edhe me përjashtjen me afatet që përdoren edhe në gjykatat ndërkombëtare.

Në lidhje me pyetjen për përfshirjen e shoqërisë civile në dhënien e mendimeve për kandidatët, unë mendoj se po, ne duhet të reflektojmë në lidhje me këtë pyetje, ashtu siç tha kolegu dhe Presidenti i Republikës mund ta realizojë një procedurë të hapur në lidhje me

tërheqjen e mendimeve. Fakti është se ka pasur President Republike që ka tentuar ta bëj një gjë të tillë, madje ka shmangur tërheqjen e mendimit politik për të tërhequr mendimin e shoqërisë civile dhe veçanërisht të shoqërisë civile, profesionale, pra shoqatat e profesionistëve. Mbase këtu duhet të rikthehemi dhe të diskutojmë në lidhje me këtë çështje.

Për sa i përket vjetërsisë në profesion, është totalisht ashtu siç tha zoti Sadushi, por mendoj se duhet parë plotësimi që ne kemi bërë në lidhje me kriteret e mësipërme, i cili do të bëhet mbi bazën e vlerësimit të meritave, në konkurrencë me njëri-tjetrin, të kandidatëve. Ne shpresojmë që mekanizmat që kemi parashikuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe organet e emërtesës ta bëjnë këtë. Është pikërisht neni 6, që ndryshon në nenin 7/a pika 3, sepse plotësimi i kriterëve dhe ai i 15 vjetshit do të bëhet mbi bazën e vjetërsisë dhe ndoshta përvojës së veçantë të kandidatit, aty vjetërsia do të lidhet me përvojën e kandidatit. Ne në raste të rralla, në rastin e juristëve shumë të shquar, mund të pranojmë me vjetërsi minimum, pra 15 vjet, është vjetërsia minimum. Pastaj në të gjitha rastet e tjera kandidatët duhet të renditen sipas arritjeve të tyre profesionale dhe përvojës në punë, të mos themi vjetërsi në punë. Vjetërsia është një nga elementet që shton përvojën e tyre në punë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Anastasi!

Ka sqarime të tjera? Nuk ka.

Ka pyetje të tjera?

Në rregull, nëse nuk ka pyetje të tjera në parim, sepse kjo është seancë në parim, i lëmë mundësi relatorit, zotit Majko, të përgatitet për ditën e mërkurë, besoj në orën 12:00, por do t'ju njoftojmë, në mënyrë që të bëjmë paraqitjen e relatorit, diskutimet në parim dhe më pas shqyrtimi nën për ne të projektligjit.

Të nderuar kolegë, faleminderit!

Falënderoj ekspertët dhe sekretariatit teknik që ishin prezent në këtë mbledhje dhe që na ndihmuan dhe na e bënë më të lehtë shqyrtimin e këtij rendi dite! Falënderoj dhe stafin që bashkëpunoi!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

